

LIGJ
Nr. 32/2026

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN E SINGAPORIT
MBI LIGJIN E MARKAVE TREGTARE, BËRË NË SINGAPOR, MË 27 MARS 2006

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare, bërë në Singapor, më 27 mars 2006, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 249, datë 16.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

TRAKTATI I SINGAPORIT MBI LIGJIN E MARKAVE TREGTARE
REZOLUTA NGA KONFERENCA DIPLOMATIKE PLOTËSUESE E TRAKTATEVE TË
SINGAPORIT PËR TË DREJTËN E MARKAVE TREGTARE
(e hartuar në Singapor, më 27 mars 2006)

DHE RREGULLORET SIPAS TRAKTATIT TË SINGAPORIT MBI LIGJIN E MARKAVE
TREGTARE
(siç është në fuqi më 1 nëntor 2011)

PËRMBAJTJA

Traktati i Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare

Rezoluta nga Konferenca Diplomatike Plotësuese e Traktatit të Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare

Rregulloret sipas Traktatit të Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare

TRAKTATI I SINGAPORIT MBI LIGJIN E MARKAVE TREGTARE

LISTA E NENEVE

Neni 1: Shprehjet e shkurtuara

Neni 2: Markat për të cilat zbatohet Traktati

Neni 3: Aplikimi

Neni 4: Përfaqësimi; adresa për shërbimin

Neni 5: Data e depozitimit

Neni 6: Regjistrimi i vetëm për mallra dhe/ose shërbime në disa kategori
 Neni 7: Ndarja e aplikimit dhe regjistrimit
 Neni 8: Komunikimet
 Neni 9: Klasifikimi i mallrave dhe/ose shërbimeve
 Neni 10: Ndryshimet në emra ose adresa
 Neni 11: Ndryshimi i pronësisë
 Neni 12: Korrigjimi i një gabimi
 Neni 13: Kohëzgjatja dhe rinovimi i regjistrimit
 Neni 14: Masat lehtësuese në rast të mosrespektimit të afateve kohore
 Neni 15: Detyrimi për të respektuar Konventën e Parisit
 Neni 16: Markat e shërbimit
 Neni 17: Kërkesa për regjistrimin e licencës
 Neni 18: Kërkesa për ndryshimin ose anulimin e regjistrimit të licencës
 Neni 19: Efektet e mosregjistrimit të një licence
 Neni 20: Treguesit e licencës
 Neni 21: Mbikëqyrjet në rast refuzimi të qëllimshëm
 Neni 22 Rregulloret
 Neni 23: Asambleja
 Neni 24: Byroja Ndërkombëtare
 Neni 25: Rishikimi ose ndryshimi
 Neni 26: Bërja palë e Traktatit
 Neni 27: Zbatimi i TLT 1994 dhe ky Traktat
 Neni 28: Hyrja në fuqi; data e hyrjes në fuqi, e ratifikimit dhe aderimit
 Neni 29: Rezervimet
 Neni 30: Denoncimi i Traktatit
 Neni 31: Gjuhët e Traktatit; nënshkrimi
 Neni 32: Depozituesi

Neni 1

Shprehje të shkurtuara

Për qëllimet e këtij Traktati, përveç nëse shprehimisht është parashtruar ndryshe:

- i. “Zyrë” nënkupton agjencinë së cilës i është besuar nga një Palë Kontraktuese regjistrimi i markave;
- ii. “Regjistrim” nënkupton regjistrimin e një marke nga një zyrë;
- iii. “Aplikim” nënkupton një aplikim për regjistrim;
- iv. “Komunikim” do të thotë çdo aplikim, kërkesë, deklaratë, korrespondencë ose informacion tjetër, në lidhje me një aplikim ose regjistrim i cili është depozituar në zyrë;
- v. Referencat për një “individ” do të interpretohen si referenca për një person fizik ashtu edhe për një person juridik;
- vi. “Mbajtës” nënkupton individin të cilin regjistri i markave e tregon si mbajtës të regjistrimit;
- vii. “Regjistër i markave” nënkupton mbledhjen e të dhënave të mbajtura nga një zyrë, e cila përfshin përmbajtjet e të gjitha regjistrimeve dhe të gjitha të dhënave të arkivuara, në lidhje me të gjitha regjistrimet, pavarësisht nga ambienti në të cilin ruhen këto të dhëna;
- viii. “Procedurë përpara zyrës” nënkupton çdo procedurë e cila është në proces përpara zyrës lidhur me një aplikim ose regjistrim;
- ix. “Konventa e Parisit” nënkupton Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, e nënshkruar në Paris, më 20 mars 1883, e rishikuar dhe e ndryshuar;

- x. “Klasifikimi i Nisës” nënkupton klasifikimin e vendosur nga Marrëveshja e Nisës, në lidhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve për Qëllime të Regjistrimit të Markave, nënshkruar në Nisë, më 15 qershor 1957, siç është rishikuar dhe ndryshuar;
- xi. “Licencë” nënkupton licencën për përdorimin e një marke sipas ligjit nga një Palë Kontraktuese;
- xii. “I licencuar” nënkupton individin të cilit i është dhënë licenca;
- xiii. “Palë Kontraktuese” nënkupton çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare, e cila është palë në këtë Traktat;
- xiv. “Konferencë Diplomatike” nënkupton thirrjen e Palëve Kontraktuese me qëllim të rishikimit ose ndryshimit të Traktatit;
- xv. “Asambleja” nënkupton Kuvendin/Asamblenë e përmendur në nenin 23;
- xvi. Referencat për një “instrument ratifikimi” do të interpretohen duke përfshirë referenca për instrumentet e pranimi dhe miratimit;
- xvii. “Organizatë” nënkupton Organizatën Botërore të Pronësisë Intellektuale;
- xviii. “Byro Ndërkombëtare” nënkupton Byronë Ndërkombëtare të Organizatës;
- xix. “Drejtor i përgjithshëm” nënkupton drejtorin e përgjithshëm të Organizatës;
- xx. “Rregulloret” nënkuptojnë rregulloret sipas këtij Traktati të cilat i referohen nenit 22;
- xxi. Referencat për një “nen” ose për një “paragraf”, “nënpagraf” ose “term” të një neni do të interpretohen duke përfshirë referencat ndaj rregullit(ave) përkatës sipas rregulloreve;
- xxii. “TLM 1994” do të thotë Traktati i Ligjit për Markat Tregtare, i hartuar në Gjenevë, më 27 tetor 1994.

Neni 2

Markat për të cilat zbatohet Traktati

1. (Natyra e Markave) Çdo Palë Kontraktuese do të zbatojë këtë Traktat për markat që përbëhen nga shenja që mund të regjistrohen si marka sipas ligjit të saj.
2. (Llojet e Markave)
 - a) Ky Traktat do të zbatohet për markat që lidhen me mallrat (markat tregtare) ose shërbimet (markat e shërbimit), ose të për të dyja mallrat dhe shërbimet.
 - b) Ky Traktat nuk do të zbatohet për markat kolektive, markat e certifikimit dhe markat e garancisë.

Neni 3

Aplikimi

1. (Treguesit ose elementet e përmbajtjes ose shoqëruese në një kërkesë, tarifa)
 - a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë të përmbajë disa ose të gjithë treguesit ose elementet e mëposhtme:
 - i. një kërkesë për regjistrim;
 - ii. emrin dhe adresën e aplikantit;
 - iii. emrin e një shteti shtetas i të cilit aplikanti është, nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti, emri i një shteti në të cilin aplikanti ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka, dhe emrin e një shteti në të cilin aplikanti ka një ndërmarrje industriale ose tregtare reale, nëse ka, ekziston një e tillë;
 - iv. ku aplikanti është një individ juridik, natyra juridike e atij individ juridik dhe e shtetit, dhe ku është e zbatueshme, njësia territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit prej të cilit është organizuar subjekti juridik në fjalë;
 - v. kur aplikanti ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
 - vi. kur një adresë për shërbim kërkohet sipas nenit 4(2)(b), adresa e tillë;

vii. kur aplikanti dëshiron të ketë prioritet nga një aplikim i mëparshëm, një deklaratë që pretendon përparësinë e aplikimit të mëparshëm, së bashku me treguesit dhe provat në mbështetje të deklaratës së përparësisë e cila mund të kërkohej në përputhje me nenin 4 të Konventës së Parisit;

viii. kur aplikanti dëshiron të përfitojë nga çdo mbrojtje që buron nga ekspozimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në një ekspozitë, një deklaratë për këtë qëllim, së bashku me treguesit në mbështetje të asaj deklarate, siç kërkohej nga ligji për palët kontraktuese;

ix. të paktën një përfaqësim të markës, siç përcaktohet në rregullore;

x. aty ku është e zbatueshme, një deklaratë, siç përshkruhet në rregullore, e cila tregon llojin e markës ashtu edhe çdo kërkesë specifike të zbatueshme për atë lloj marke;

xi. aty ku është e zbatueshme, një deklaratë, siç përshkruhet në rregullore, që tregon se aplikanti dëshiron që marka të regjistrohet dhe të publikohet me germat standarde të përdorura nga zyra;

xii. aty ku është e zbatueshme, një deklaratë, siç përshkruhet në rregullore, që tregon se aplikanti kërkon që të jetë ngjyra si një tipar dallues i markës;

xiii. transliterim/tejskhronjzim i markës ose i pjesëve të caktuara të markës;

xiv. përkthim i markës ose i pjesëve të caktuara të markës;

xv. emrat e mallrave ose shërbimeve për të cilat kërkohej regjistrimi, të klasifikuar sipas kategorive të klasifikimit të Nisës, secili grup i paraprirë nga numri i kategorisë së atij klasifikimi të cilit i përket ai grup mallrash ose shërbimesh dhe të paraqitura sipas renditjes së kategorive të klasifikimit në fjalë;

xvi. një deklaratë lidhur me qëllimin për të përdorur markën, siç kërkohej nga ligji për Palët Kontraktuese.

b) Aplikanti mund të paraqesë në vend të saj ose krahas deklaratës së qëllimit për të përdorur markën e përmendur në nënparagrafin (a)(xvi), një deklaratë të përdorimit të tanishëm të markës dhe prova për këtë qëllim, siç kërkohej nga ligji për Palët Kontraktuese.

c) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që në lidhje me aplikimin t'i paguhen tarifat zyrës.

2. (Aplikim i vetëm për mallra ose shërbime në disa kategori), i njëjti aplikim mund të lidhet me disa mallra ose shërbime, pavarësisht nëse ato i përkasin një kategorie apo disa kategorive të klasifikimit të Nisës.

3. (Përdorimi ekzistues) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që, kur një deklaratë e synuar për përdorim është paraqitur sipas paragrafit (1)(a)(xvi), aplikanti t'i dorëzojë Entitets brenda një afati kohor të përcaktuar në ligjin e tij, duke iu nënshtruar afatit kohor minimal të përcaktuar në Rregullore, dëshmi e përdorimit aktual të markës, siç kërkohej nga ligji në fjalë.

4. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 3, dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me aplikimin. Në veçanti, sa më poshtë mund të mos kërkohej në lidhje me kërkesën gjatë të gjithë periudhës së pezullimit:

i. dhënien e çfarëdolloj certifikate ose ekstrakti nga një regjistër tregtar;

ii. tregues për ushtrimin e një aktiviteti industrial ose tregtar nga aplikanti, si edhe paraqitjen e provave për këtë qëllim;

iii. një tregues të ushtrimit të një aktiviteti nga aplikanti, që përputhet me mallrat dhe/ose shërbimet e shënuara në aplikim, si dhe parashtrimin e provave për këtë qëllim;

iv. dhënien e provave që tregojnë se marka është regjistruar në regjistrin e markave të një Pale tjetër Kontraktuese ose të një Shteti Palë në Konventën e Parisit që nuk është Palë Kontraktuese, përveç rasteve kur aplikanti pretendon zbatimin e nenit 6 *quinquies* të Konventës së Parisit.

5. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t'i jepen prova gjatë shqyrtimit të kërkesës, në rastin kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e ndonjë treguesi, ose elementi të përfshirë në kërkesë.

Përfaqësimi; adresa për shërbim

1. (Përfaqësuesit e pranuar për ta zbatuar)

a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një përfaqësues i caktuar për qëllimet e çdo procedure para zyrës;

i. kanë të drejtë që sipas ligjit në fuqi të ushtrojnë/paraqesin praktikën pranë zyrës në lidhje me aplikimet dhe regjistrimet, dhe aty ku është e zbatueshme, të pranohen për të ushtruar para zyrës/institucionit;

ii. të sigurojë, si adresë të tij, një adresë në një territor të përshkruar nga Pala Kontraktuese;

b) Një akt, në lidhje me çdo procedurë përpara zyrës, nga ose në lidhje me një përfaqësues që përmbush kërkesat e aplikuar nga Pala Kontraktuese sipas nënparagrafit (a), do të ketë efektin e një akti nga ose në lidhje me aplikantin, mbajtësi ose individ tjetër i interesuar që e ka caktuar atë përfaqësues.

2. (Përfaqësimi i detyrueshëm; adresa për shërbimin)

a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë, që për qëllimet e çdo procedure përpara zyrës, një aplikant, mbajtës ose individ tjetër i interesuar që nuk ka as vendbanim, as një ndërmarrje reale dhe industriale ose tregtare aktive në territorin e saj, të përfaqësohet nga një përfaqësues.

b) Çdo Palë Kontraktuese, në masën që nuk kërkon përfaqësim në përputhje me nënparagrafin (a), mund të kërkojë që, për qëllimet e çdo procedure përpara zyrës, një aplikant, mbajtës ose individ tjetër të interesuar që nuk ka asnjë vendbanim të përhershëm, as një ndërmarrje ekzistuese dhe aktive industriale ose tregtare në territorin e saj, kanë një adresë shërbimi në atë territor.

3. (Prokura)

a) Kurdoherë që një Palë Kontraktuese lejon ose kërkon që një aplikant, një mbajtës ose një individ tjetër i interesuar të përfaqësohet nga një përfaqësues përpara zyrës, ajo mund të kërkojë që përfaqësuesi të emërohet nëpërmjet një komunikimi të veçantë (që këtej e tutje referuar si “prokura”), duke treguar emrin e aplikantit, mbajtësit ose individit tjetër sipas rastit.

b) Prokura mund të lidhet me një ose më shumë aplikime dhe/ose regjistrime të identifikuar në autorizim ose, me çdo përjashtim të treguar nga individ që e emëron, për të gjitha aplikimet dhe/ose regjistrimet ekzistuese dhe të ardhshme të atij individ.

c) Prokura mund të kufizojë kompetencat e përfaqësuesit në disa akte. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të kërkojë që çdo autorizim, sipas të cilit përfaqësuesi ka të drejtë të tërheqë një kërkesë ose të dorëzojë një regjistrim, të përmbajë një tregues të shprehur për këtë qëllim.

d) Kur një komunikim i dorëzohet zyrës nga një individ i cili i referohet vetes në komunikim si përfaqësues, por kur zyra, në momentin e marrjes së komunikatës, nuk posedon autorizimin e kërkuar, pala kontraktuese mund të kërkojë që autorizimi t’i dorëzohet zyrës brenda afatit kohor të caktuar nga pala kontraktuese, duke iu nënshtruar afatit kohor minimal të përcaktuar në rregullore. Çdo palë kontraktuese mund të parashikojë që, kur autorizimi nuk i është dorëzuar zyrës brenda afatit kohor të caktuar nga Pala Kontraktuese, komunikimi nga individ në fjalë nuk do të ketë efekt.

4. (Referenca në autorizimin) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që çdo komunikim i bërë zyrës nga një përfaqësues për qëllime të një procedure para zyrës të përmbajë një referencë në autorizimin në bazë të së cilës përfaqësuesi vepron.

5. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 3 dhe 4, dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me çështjet e trajtuara në këto paragrafë.

6. (Prova) Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t’i jepen prova kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e çdo treguesi të përfshirë në çdo komunikim të përmendur në paragrafët 3 dhe 4.

Data e depozitimit

1. (Kërkesat e lejuara)

a) Në varësi të nënparagrafit “b” dhe paragrafit 2, një Palë Kontraktuese do t’i japë si datë depozitimi të një aplikimi datën në të cilën zyra mori treguesit dhe elementet e mëposhtme në gjuhën e kërkuar sipas nenit 8(2):

- i. një tregues i shprehur ose i nënkuptuar se kërkohet regjistrimi i një marke;
- ii. tregues që lejojnë përcaktimin e identitetit të aplikantit;
- iii. treguesit që lejojnë aplikantin ose përfaqësuesin e tij, nëse ka një të tillë, të kontaktohet nga zyra;
- iv. një pasqyrim mjaft të qartë të markës për të cilën kërkohet regjistrimi;
- v. listën e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi;
- vi. kur zbatohet neni 3(1)(a)(xvi) ose (b), deklarata e përmendur në nenin 3(1)(a)(xvi) ose deklarata dhe provat e përmendura në nenin 3(1)(b), përkatësisht siç kërkohet nga ligji për Palët Kontraktuese.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund t’i akordojë si datë depozitimit të aplikimit datën në të cilën zyra ka marrë vetëm disa, dhe jo të gjitha, nga treguesit dhe elementet e përmendura në nënparagrafin (a) ose i ka marrë ato në një gjuhë të ndryshme nga gjuha e kërkuar sipas nenit 8(2).

2. (Kërkesa plotësuese të lejuara)

a) Pala Kontraktuese mund të kushtëzojë, që të mos vendoset asnjë datë depozitimi derisa të paguhet tarifat e kërkuara të shërbimit.

b) Pala Kontraktuese mund të zbatojë kërkesën e përmendur në nënparagrafin (a) vetëm nëse e ka zbatuar një kërkesë të tillë në kohën kur është bërë palë në këtë Traktat.

3. (Korrigjimet dhe afatet kohore) Modalitetet dhe afatet kohore për korrigjimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 do të përcaktohen në Rregullore.

4. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të përmbushen në lidhje me datën e depozitimit.

Neni 6

Regjistrim i vetëm për mallra dhe/ose shërbime në disa kategori

Kur mallrat dhe/ose shërbimet që i përkasin disa kategorive të klasifikimit të Nisës janë përfshirë në të njëjtin aplikim, një aplikim i tillë do të rezultojë në një të vetëm dhe në të njëjtin regjistrim.

Neni 7

Ndarja e aplikimit dhe regjistrimit

1. (Ndarja e aplikimit)

a) Çdo aplikim i cili rendit disa mallra dhe/ose shërbime (që këtej e tutje referuar si “aplikim fillestar”) mund:

- i. të paktën deri në vendimin e zyrës për regjistrimin e markës,
 - ii. gjatë çdo procedure ligjore/gjyqësore kundër vendimit të zyrës për regjistrimin e markës;
 - iii. gjatë çdo procedure ankimi kundër vendimit për regjistrimin e markës;
- të ndahet nga aplikanti ose me kërkesën e tij në dy ose më shumë aplikime (në tekstin e mëtejshëm “kërkesa të ndara”) duke shpërndarë midis këtyre të fundit mallrat dhe/ose shërbimet e renditura në aplikimin fillestar. Aplikimet e ndara ruajnë datën e depozitimit të aplikimit fillestar dhe përfitimin e së drejtës së përparësisë, nëse ka.

b) Çdo Palë Kontraktuese, në varësi të nënparagrafit (a), do të jetë e lirë të vendosë kërkesat për ndarjen e një aplikimi, duke përfshirë pagesën e tarifave.

2. (Ndarja e regjistrimit) Paragrafi 1 zbatohet, *mutatis mutandis*, në lidhje me ndarjen e regjistrimit. Një ndarje e tillë do të lejohet:

i. gjatë çdo procesi në të cilin vlefshmëria e regjistrimit kundërshtohet para zyrës nga një palë e tretë;

ii. gjatë çdo procedure ankimi kundër një vendimi të marrë nga zyra gjatë procedurës gjyqësore të mëparshme;

me kusht që një palë kontraktuese mund të përjashtojë mundësinë e ndarjes së regjistrimeve nëse ligji i saj lejon palët e treta të kundërshtojnë regjistrimin e një marke përpara se marka të regjistrohet.

Neni 8 **Komunikimet**

1. (Mjetet e transmetimit dhe forma e komunikimit) Çdo Palë Kontraktuese mund të zgjedhë mjetet e transmetimit të komunikimit dhe nëse pranon komunikime me shkrim, komunikime në formë elektronike apo çdo formë tjetër komunikimi.

2. (Gjuha e komunikimit)

a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që të gjitha komunikimet të jenë në një gjuhë të pranuar nga zyra. Në rastet kur zyra pranon më shumë se një gjuhë, aplikantit, mbajtësit ose individ tjetër i interesuar mund t'i kërkohet të përmbushë çdo kërkesë tjetër gjuhësore të zbatueshme në lidhje me zyrën, me kusht që asnjë tregues ose element i komunikimit të mos kërkohet të jetë në më shumë se një gjuhë.

b) Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, dëshminë, legalizimin ose çfarëdolloj vërtetimi tjetër të çdo përkthim të një komunikimi të ndryshëm nga sa parashikohet në këtë Traktat.

c) Kur një Palë Kontraktuese nuk kërkon që një komunikim të jetë në një gjuhë të pranuar nga zyra saj, zyra mund të kërkojë që t'i sigurohet një përkthim i atij komunikimi nga një përkthyes zyrtar ose një përfaqësues, në një gjuhë të pranuar nga Entiteti brenda një afati kohor të arsyeshëm.

3. (Nënshkrimi i dokumenteve me shkrim)

a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një dokument me shkrim të nënshkruhet nga aplikanti, mbajtësi ose një individ tjetër i interesuar. Kur një Palë Kontraktuese kërkon që një dokument me shkrim të nënshkruhet, ajo Palë Kontraktuese do të pranojë çdo nënshkrim që përputhet me kërkesat e përcaktuara në rregullore.

b) Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, certifikimin, legalizimin ose dokumentimin tjetër të çdo nënshkrimi, përveç rasteve kur ligji për Palët Kontraktuese e parashikon këtë, në rast se nënshkrimi ka të bëjë me dorëzimin e një regjistrimi.

c) Pavarësisht nga nënparagrafi (b), një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që provat të depozitohen në zyra, në rastin kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e çdo nënshkrimi të një dokumenti me shkrim.

4. (Fushat e komunikimit në formë elektronike ose format e transmetimit elektronik) Kur një Palë Kontraktuese lejon komunikimin në formë elektronike ose me forma të transmetimit elektronik, ajo mund të kërkojë që çdo komunikim i tillë të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore.

5. (Paraqitja e një dokumenti) Çdo Palë Kontraktuese do të pranojë paraqitjen e një komunikimi, përmbajtja e të cilit përputhet me Modelin e Formularit Ndërkombëtar përkatës nëse ka, të parashikuar në rregullore.

6. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë, që në lidhje me paragrafët 1 deri në 5 të përmbushen kërkesat e tjera nga ato të përmendura në këtë nen.

7. (Format e komunikimit me përfaqësuesin) Asgjë në këtë nen nuk rregullon mjetet e komunikimit ndërmjet aplikantit, mbajtësit apo individit tjetër të interesuar dhe përfaqësuesit të tij.

Neni 9

Klasifikimi i mallrave dhe/ose shërbimeve

1. (Treguesit e mallrave dhe/ose shërbimeve) Çdo regjistrim dhe çdo publikim i kryer nga një zyrë që ka të bëjë me një aplikim ose regjistrim dhe që tregon mallrat dhe/ose shërbimet duhet të tregojë mallrat dhe/ose shërbimet me emrat e tyre, të grupuar sipas kategorive të klasifikimit të Nisës, dhe çdo grup do të paraprihet nga numri i kategorisë së atij klasifikimi të cilit i përket ai grup mallrash ose shërbimesh dhe do të paraqitet sipas renditjes së kategorive të klasifikimit në fjalë.

2. (Mallra ose shërbime në të njëjtën kategori, ose në kategori të ndryshme)

a) Mallrat ose shërbimet nuk mund të konsiderohen si të ngjashme me njëra-tjetrën për arsye se, në çdo regjistrim ose publikim nga zyra, ato paraqiten në të njëjtën kategori të klasifikimit të Nisës.

b) Mallrat ose shërbimet nuk mund të konsiderohen si të ndryshme nga njëra-tjetra, për arsye se, në çdo regjistrim ose publikim nga zyra ato shfaqen në kategori të ndryshme të klasifikimit të Nisës.

Neni 10

Ndryshime në emra ose adresa

1. (Ndryshimet në emrin ose adresën e mbajtësit)

a) Kur nuk ka ndryshim në individin e mbajtësit, por ka një ndryshim në emrin dhe/ose adresën e saj, secila Palë Kontraktuese do të pranojë që një kërkesë për regjistrimin e ndryshimit nga zyra në regjistrin e saj të markave të bëhet bërë nga mbajtësi në një komunikim që tregon numrin e regjistrimit për regjistrimit në fjalë dhe ndryshimet që do të regjistrohet.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të tregojë:

i. emrin dhe adresën e mbajtësit;

ii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

iii. kur mbajtësi ka një adresë për shërbim, një adresë të tillë.

c) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që, në lidhje me kërkesën, t'i paguhet një tarifë shërbimi i zyrës.

d) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim, me kusht që numrat e regjistrimit të të gjitha regjistrimeve në fjalë të tregohen në kërkesë.

2. (Ndryshime në emrin ose adresën e aplikantit) Paragrafi 1 do të zbatojë *mutatis mutandis*, kur ndryshimi ka të bëjë me një aplikim ose aplikime me të dyja, si aplikimin dhe aplikimet, me një regjistrim ose regjistrimet, me kusht që kur numri i aplikimit të çdo aplikimi në fjalë, nuk është lëshuar ende ose nuk është i njohur për aplikantin, ose përfaqësuesin e tij, në të kundërt kërkesa e identifikon atë aplikim siç është e përshkruar në rregullore.

3. (Ndryshim në emrin ose adresën e përfaqësuesit ose në adresën e shërbimit) Paragrafi 1 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për çdo ndryshim në emrin ose adresën e përfaqësuesit, nëse ka, dhe për çdo ndryshim në lidhje me adresën për shërbim, nëse ka.

4. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 deri në 3 dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me kërkesën e përmendur në këtë nen. Në veçanti, mund të mos kërkohet dhënia e ndonjë certifikate në lidhje me ndryshimin.

5. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund t'i kërkohet që zyrës t'i jepen prova, në rast se zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e secilit prej treguesve të përfshirë në kërkesë.

Neni 11

Ndryshimi në pronësi

1. (Ndryshim në pronësinë e një regjistrimi)

a) Kur ka një ndryshim në individin e mbajtësit, secila Palë Kontraktuese do të pranojë që një kërkesë për regjistrimin e ndryshimit nga Entiteti në regjistrin e saj të markave të bëhet nga mbajtësi ose nga individ i që ka fituar pronësinë (që këtej e tutje “pronar i ri”) në një komunikim që tregon numrin e regjistrimit të regjistrimit në fjalë dhe ndryshimin që do të regjistrohet.

b) Kur ndryshimi i pronësisë rezulton nga një kontratë, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të tregojë këtë fakt dhe të shoqërohet, sipas dëshirës së palës kërkuese, nga një nga sa vijon:

i. një kopje të kontratës, kopje e së cilës mund të kërkohej të vërtetohet, nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, si në përputhje me kontratën origjinale;

ii. një ekstrakt të kontratës që tregon ndryshimin në pronësi, ekstrakt mund të kërkohej të vërtetohet, nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, si një ekstrakt i vërtetë i kontratës;

iii. një certifikatë/dokument transferimi të pavërtetuar, të hartuar në formë dhe përmbajtje ashtu siç përcaktohet në rregullore dhe të nënshkruar nga të dyja palët, si nga mbajtësi ashtu edhe nga pronari i ri;

iv. një dokument transferimi i pavërtetuar, i hartuar në formë dhe përmbajtje, ashtu siç përcaktohet në rregullore dhe i nënshkruar si nga mbajtësi ashtu edhe nga pronari i ri.

c) Kur ndryshimi i pronësisë rezulton nga një bashkim, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të tregojë këtë fakt dhe të shoqërohet nga një kopje e një dokumenti, i cili buron nga autoriteti kompetent dhe dëshmon bashkimin. Ky dokument mund të jetë kopje e një ekstrakti nga një regjistër tregtar dhe kjo kopje të vërtetohet nga autoriteti i cili e ka lëshuar dokumentin siç mund të jetë një noter ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, duke qenë në përputhje me dokumentin origjinal.

d) Kur ka një ndryshim në individin e një ose më shumë, por jo të gjithëve, prej bashkëpronarëve dhe një ndryshim i tillë në pronësi rezulton nga një kontratë ose një bashkim, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që çdo bashkëmbajtës në lidhje me të cilin nuk ka ndryshim në pronësi të japë pëlqimin e tij të shprehur për ndryshimin e pronësisë në një dokument të nënshkruar nga ata.

e) Kur ndryshimi i pronësisë nuk rezulton nga një kontratë ose një bashkim, por nga një arsye tjetër, për shembull, nga zbatimi i ligjit ose një vendim gjykate, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa ta dëshmojë atë fakt dhe të shoqërohet nga një kopje e një dokumenti që vërteton ndryshimin dhe që ajo kopje të vërtetohet se është në përputhje me dokumentin origjinal nga autoriteti që ka lëshuar dokumentin, siç mund të jetë një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik i cili është kompetent.

f) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të tregojë:

i. emrin dhe adresën e mbajtësit;

ii. emrin dhe adresën e pronarit të ri;

iii. emrin e një shteti, shtetas i të cilit është pronari i ri nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti, emri i një shteti në të cilin pronari i ri ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka, dhe emrin e një shteti në të cilin pronari i ri ka një kompani reale dhe efektive industriale ose tregtare, nëse ka;

iv. kur pronari i ri është një person juridik, aspekti ligjor i personit juridik dhe i shtetit, kur është e zbatueshme, njësia territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit të të cilit është organizuar personi juridik në fjalë;

v. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;

vi. kur mbajtësi ka një adresë për shërbim, adresën e tillë;

vii. kur pronari i ri ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;

viii. kur pronarit të ri i kërkohej të ketë një adresë për shërbim sipas nenit 4(2)(b), një adresë e tillë.

g) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që, në përputhje me kërkesën t'i paguhet një tarifë Entitets.

h) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur ndryshimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim, me kusht që mbajtësi dhe pronari i ri të jenë të njëjtë për çdo regjistrim dhe që numrat e regjistrimit të të gjitha regjistrimeve në fjalë të tregohen në kërkesë.

i) Kur ndryshimi i pronësisë nuk prek të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet e shënuara në regjistrimin e mbajtësit dhe ligji në fuqi lejon regjistrimin e një ndryshimi të tillë, Entiteti do të krijojë një regjistrim të veçantë duke iu referuar mallrave dhe/ose shërbimeve në lidhje me të cilat ka ndryshuar pronësia.

2. (Ndryshimi në pronësinë e një aplikimi) Paragrafi 1 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, kur ndryshimi i pronësisë ka të bëjë me një aplikim ose aplikime, me një aplikim dhe një regjistrim ose regjistrime, me kusht që kur numri i aplikimit të çdo aplikimi në fjalë nuk është lëshuar ende ose nuk është i njohur për aplikantin apo përfaqësuesin e tij, në të kundërt kërkesa e identifikon atë aplikim siç përcaktohet në rregullore.

3. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me kërkesën e përmendur në këtë nen. Në veçanti, pikat më poshtë mund të mos kërkohet:

i. në varësi të paragrafit (1)(c), dhënien e çdo certifikate ose ekstrakti nga një regjistër tregtar;

ii. një tregues për ushtrimin e një aktiviteti industrial ose tregtar nga pronari i ri, si dhe dhënien e provave për këtë klauzolë;

iii. një tregues i kryerjes së një aktiviteti nga pronari i ri që korrespondon me mallrat dhe/ose shërbimet e prekura nga ndryshimi i pronësisë, si dhe parashtrimin e provave për secilën klauzolë;

iv. një tregues që mbajtësi transferoi, tërësisht ose pjesërisht, biznesin e tij ose emrin e mirë përkatës te pronari i ri, si dhe dhënien e provave për secilën klauzolë;

4. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t'i paraqiten prova ose prova të mëtejshme kur zbatohet paragrafi (1)(c) ose (e), në rastin se zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e ndonjë treguesi të përfshirë në kërkesë, ose në ndonjë dokument të përmendur në këtë nen.

Neni 12

Korrigjimi i një gabimi

1. (Korrigjimi i një gabimi për sa i përket regjistrimit)

a) Secila Palë Kontraktuese do të pranojë që të parashtrohet kërkesa për korrigjimin e një gabimi që është bërë në aplikim ose kërkesë tjetër, i cili i është komunikuar zyrës dhe që gabimi është pasqyruar në regjistrin e saj të markave dhe/ose që çdo publikim tjetër nga zyra, të bëhet nga mbajtësi përmes një komunikimi i cili dëshmon numrin e regjistrimit në fjalë, gabimi duhet korrigjuar dhe korrigjimi duhet të regjistrohët.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të përcaktojë:

i. emrin dhe adresën e mbajtësit;

ii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;

iii. kur mbajtësi ka një adresë për shërbim, adresën përkatëse;

c) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që për sa i përket kërkesës, zyrës t'i paguhet një tarifë;

d) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur korrigjimi ka të bëjë me më shumë se një regjistrim të të njëjtit individ, me kusht që gabimi dhe korrigjimi i kërkuar janë të njëjta për çdo regjistrim dhe që numrat e regjistrimit të të gjitha regjistrimeve në fjalë janë të shënuara në kërkesë.

2. (Korrigjimi i një gabimi në lidhje me një aplikim) Paragrafi 1 do të zbatohet *mutatis mutandis*, kur gabimi ka të bëjë me një aplikim ose aplikime, ose me të dyja bashkë, një aplikim ose aplikime, dhe një regjistrim ose regjistrime, me kushtin që kur numri i aplikimit të për aplikimin në fjalë nuk

është lëshuar ende ose nuk është i njohur për aplikantin dhe përfaqësuesin e tij, në rast të kundërt kërkesa e identifikon atë aplikim siç përcaktohet në rregullore.

3. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me kërkesën e përmendur në këtë nen.

4. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t'i jepen prova, ku zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme se gabimi i pretenduar është në fakt një gabim.

5. (Gabimet e bëra nga zyra) Zyra e një Pale Kontraktuese do të korrigjojë gabimet e veta, *ex officio* sipas kërkesës, pa pagesë.

6. (Gabimet e pakorrigjueshme) Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të zbatojë paragrafët 1, 2 dhe 5, për çdo gabim që nuk mund të korrigjohet sipas ligjit të saj.

Neni 13

Kohëzgjatja dhe rinovimi i regjistrimit

1. (Treguesit ose elementet që përmbajnë, ose shoqërojnë një kërkesë për rinovim; tarifa)

a) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që rinovimi i një regjistrimi të jetë subjekt i paraqitjes së një kërkesë dhe që një kërkesë e tillë të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e mëposhtëm:

i. një tregues përse kërkohet rinovimi;

ii. emrin dhe adresën e mbajtësit;

iii. numrin e regjistrimit lidhur me regjistrimin në fjalë;

iv. sipas zgjedhjes së Palës Kontraktuese, datën e depozitimit të aplikimit që rezultoi në regjistrimin në fjalë ose datën e regjistrimit për sa i përket regjistrimit në fjalë;

v. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

vi. kur mbajtësi ka një adresë për shërbim, adresën përkatëse;

vii. kur Pala Kontraktuese lejon që të bëhet rinovimi i një regjistrimi vetëm për disa nga mallrat dhe/ose shërbimet që janë regjistruar në regjistrin e markave dhe kërkohet një rinovim i tillë, emrat e mallrave të regjistruara dhe/ose shërbimet për të cilat kërkohet rinovimi ose emrat e mallrave dhe/ose shërbimeve të regjistruara për të cilat nuk kërkohet rinovimi, të grupuara sipas kategorive të Klasifikimit të Nisës, secili grup i paraprirë nga numri i kategorisë së atij klasifikimi në të cilin ai grup mallrash ose shërbimesh i përket dhe paraqitet sipas renditjes së kategorive të klasifikimit në fjalë;

viii. kur një Palë Kontraktuese lejon që një kërkesë për rinovim të paraqitet nga një individ i ndryshëm nga mbajtësi ose përfaqësuesi i saj dhe kërkesa është paraqitur nga një individ i tillë, emri dhe adresa e atij individi.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që, në lidhje me kërkesën për rinovim, t'i paguhet një tarifë zyrës. Pasi të jetë paguar tarifa në lidhje me periudhën fillestare të regjistrimit ose të ndonjë periudhe rinovimi, nuk mund të kërkohet asnjë pagesë e mëtejshme për ruajtjen e regjistrimit në lidhje me atë periudhë. Tarifat të cilat kanë të bëjnë me dhënien e një deklarate dhe/ose dëshmi përdorimi nuk do të merren parasysh, për qëllimet e këtij nënparagrafi, si pagesa të kërkuara për mirëmbajtjen e regjistrimit dhe nuk do të ndikohen nga ky nënparagraf.

c) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për rinovim të paraqitet dhe tarifa përkatëse e përmendur në nënparagrafin (b) t'i paguhet zyra brenda periudhës së përcaktuar nga ligji për Palën Kontraktuese, duke iu nënshtruar periudhave minimale të përcaktuara në rregullore.

2) (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në paragrafin 1 dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me kërkesën për rinovim. Në veçanti, sa më poshtë mund të mos kërkohet:

i. çdo paraqitje ose identifikim tjetër i markës;

- ii. parashtrimin e provave që tregojnë se marka është regjistruar ose se regjistrimi i saj është rinovuar, në çdo regjistër tjetër markash;
 - iii. dhënien e një deklarate dhe/ose dëshmie në lidhje me përdorimin e markës.
3. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t'i jepen prova gjatë shqyrtimit të kërkesës për rinovim, kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e ndonjë treguesi ose elementi të përfshirë në kërkesën për rinovim.
4. (Ndalimi i shqyrtimit themelor) Asnjë zyrë Pale Kontraktuese nuk mund të shqyrtojë regjistrimin për sa i përket përmbajtjes, për qëllim të efektit të rinovimit.
5. (Kohëzgjatja) Kohëzgjatja e periudhës fillestare të regjistrimit dhe kohëzgjatja e çdo periudhe ripërtëritjeje do të jetë 10 vjet.

Neni 14

Masat lehtësuese në rast të mospërmbushjes së afateve kohore

1. (Masë lehtësimi para skadimit të një afati kohor) Një palë kontraktuese mund të parashikojë zgjatjen e një afati kohor për një veprim në një procedurë para Entitets në lidhje me një aplikim ose një regjistrim, nëse një kërkesë për këtë qëllim depozitohet në Entitet para skadimit të afatit.
2. (Masat lehtësuese pas skadimit të një afati kohor) Kur një aplikant, mbajtësi ose individ tjetër i interesuar nuk ka përmbushur një afat kohor (afati kohor në fjalë) për një veprim në një procedurë para Entitets së një Pale Kontraktuese në lidhje me një aplikim ose regjistrim, Pala Kontraktuese do të parashikojë një ose më shumë nga masat e mëposhtme të lehtësimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore, nëse një kërkesë për këtë qëllim paraqitet në Entitet:
- i. zgjatja e afatit kohor në fjalë për periudhën e përcaktuar në rregullore;
 - ii. vazhdimi i përpunimit në lidhje me aplikimin ose regjistrimin;
 - iii. rivendosja e të drejtave të aplikantit, mbajtësit ose individit tjetër të interesuar, në lidhje me aplikimin ose regjistrimin nëse Entiteti konstaton se mosrespektimi i afatit kohor në fjalë ka ndodhur pavarësisht nga kujdesi i duhur i kërkuar nga rrethanat që janë marrë ose, sipas opsionit të Palës Kontraktuese, se dështimi ishte i paqëllimshëm.
3. (Përfshirjet) Asnjë Pale Kontraktuese nuk do t'i kërkojë të parashikojë asnjë nga masat e lehtësimit të përmendura në paragrafin 2, në lidhje me përjashtimet e përkrahura në rregullore.
4. (Tarifa) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që të paguhet një tarifë në përputhje me ndonjë nga masat e lehtësimit të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.
5. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera nga ato të përmendura në këtë nen dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me ndonjë nga masat e lehtësimit të përmendura në paragrafin 2.

Neni 15

Detyrimi për të respektuar Konventën e Parisit

Çdo Palë Kontraktuese do të respektojë dispozitat e Konventës së Parisit që kanë të bëjnë me markat.

Neni 16

Markat e shërbimit

Çdo Palë Kontraktuese do të regjistrojë markat e shërbimit dhe do të zbatojë për këto marka dispozitat e Konventës së Parisit që kanë të bëjnë me markat tregtare.

Neni 17

Kërkesa për regjistrimin e një licence

1. (Kushtet lidhur me kërkesën për regjistrim) Kur ligji i një Pale Kontraktuese parashikon regjistrimin e një licence në zyrën e saj, ajo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrim:

- i. të dorëzohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;
- ii. të shoqërohet me dokumentet mbështetëse të përshkruara në rregullore;

2. (Tarifa) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë, që për sa i përket regjistrimit të një licence, t'i paguhet një tarifë zyres përkatëse.

3. (Kërkesë e vetme për disa regjistrime) Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur licenca ka të bëjë me më shumë se një regjistrim, me kusht që numrat e depozitimit të të gjitha regjistrimeve në fjalë të paraqiten në kërkesë, mbajtësi dhe i licencuari janë të njëjta për të gjitha regjistrimet dhe kërkesa tregon qëllimin e licencës, në përputhje me rregulloret dhe që ka të bëjë me këto të fundit.

4. (Moslejimi i kërkesave të tjera)

a) Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera përveç atyre të përmendura në paragrafët 1 deri në 3 dhe në nenin 8 të përmbushen në lidhje me regjistrimin e një licence në Zyrën e saj. Përkatësisht pikat që vijojnë mund të mos kërkojnë:

- i. dhënia e certifikatës së regjistrimit të markës e cila është objekt i licencës;
- ii. dhënia e kontratës së licencës ose një përkthim i saj;
- iii. një tregues i kushteve financiare të kontratës së licencës.

b) Nënparagrafi (a) nuk përjashton asnjë detyrim që ekziston sipas ligjit të një Pale Kontraktuese, në lidhje me zbulimin/dhënien e informacionit për qëllime të ndryshme nga regjistrimi i licencës në regjistrin e markave.

5. (Prova) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që zyres t'i jepen prova, kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e çdo treguesi të përfshirë në kërkesë ose në ndonjë dokument të përmendur në rregullore.

6. (Kërkesat lidhur me aplikimet) Paragrafët 1 deri në 5 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për kërkesat që kanë të bëjnë me regjistrimin e një licence për sa i përket aplikimit, kur ligji për Palët Kontraktuese parashikon një regjistrim të tillë.

Neni 18

Kërkesat për amendamentin ose anulimin e regjistrimit të një licence

1. (Kushtet në lidhje me kërkesën) Kur ligji për Palët Kontraktuese parashikon regjistrimin e një licence në zyrën e tij, Palët Kontraktuese mund të kërkojnë që kërkesa për amendimin ose anulim të regjistrimit të një licence:

- i. të dorëzohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore; dhe
- ii. të shoqërohet me dokumentet plotësuese të përshkruara në rregullore.

2. (Kërkesa të tjera) Neni 17 (2) deri në 6 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për kërkesat lidhur me amendimin ose anulimin e regjistrimit të licencës.

Neni 19

Efektet e mosregjistrimit të një licence

1. (Vlefshmëria e regjistrimit dhe mbrojtjes së markës) Mosregjistrimi i një licence në zyrë ose me ndonjë autoritet tjetër të Palës Kontraktuese, nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e regjistrimit të markës, e cila është objekt i licencës ose mbrojtjes së asaj marke.

2. (Disa të drejta të të licencuarit) Një Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë regjistrimin e një licence, si kusht për çdo të drejtë që i licencuari mund të ketë sipas ligjit të asaj Pale Kontraktuese për t'i hyrë procedurave të shkeljes ligjore të filluara nga mbajtësi, ose për të marrë, me anë të procedurave të tilla, kompensimet që burojnë nga shkelja ligjore e markës e cila është objekt i licencës.

3. (Përdorimi i një marke kur licenca nuk regjistrohet) Një palë kontraktuese nuk mund të kërkojë regjistrimin e një licence, si kusht që përdorimi i një marke nga një i licencuar të konsiderohet se përbën shfrytëzim nga mbajtësi në procedurat që kanë të bëjnë me blerjen, ruajtjen dhe zbatimin e markave.

Neni 20

Treguesit e licencës

Kur ligji për Palët Kontraktuese kërkon një tregues që marka përdoret nën një licencë, mospërputhja e plotë ose e pjesshme me këtë kërkesë nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e regjistrimit të markës që është objekt i licencës ose në mbrojtjen e kësaj të fundit dhe nuk do të prekë zbatimin e nenit 19(3).

Neni 21

Mbikëqyrjet në rast të refuzimit të qëllimshëm

Një aplikim sipas nenit 3 ose një kërkesë sipas neneve 7, 10 deri në 14, 17 dhe 18 nuk mund të refuzohet plotësisht ose pjesërisht nga një zyrë pa i dhënë aplikantit ose palës e cila ka paraqitur kërkesën, sipas rastit, një mundësi për të parashtruar vërejtje për sa i përket refuzimit të qëllimshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në përputhje me nenin 14, asnjë zyre nuk do t'i kërkohej të japë mundësinë për të dhënë vërejtje, kur personi i cili kërkon masën lehtësuese, ka pasur tashmë mundësinë të paraqesë një rishikim lidhur me faktet mbi të cilat do të bazohet vendimi.

Neni 22

Rregulloret

1. (Përmbajtja)

a) Rregulloret e bashkëngjitura në këtë Traktat parashikojnë rregulla në lidhje me:

i. çështjet që ky Traktat parashikon shprehimisht të “përshkruhen në rregullore”;

ii. çdo të dhënë të dobishme në zbatimin e dispozitave të këtij Traktati;

iii. çdo kërkesë, çështje ose procedurë administrative;

b) Rregulloret, gjithashtu, përmbajnë formularë të modelit ndërkombëtar.

2. (Amendimi i rregulloreve) I kushtëzuar nga paragrafi 3, çdo ndryshim i rregulloreve kërkon tri të katërtat e votave të dhëna.

3. (Kërkesa për unanimitet)

a) Rregulloret mund të përcaktojnë dispozita që kanë të bëjnë me ato, të cilat mund të ndryshohen vetëm me unanimitet.

b) Çdo amendim/ndryshim i rregulloreve që rezulton në shtimin ose heqjen e dispozitave prej tij, dispozitat e specifikuar në rregullore në përputhje me nënparagrafin (a), do të kërkojë unanimitet;

c) Në përcaktimin nëse arrihet unanimiteti, do të merren parasysh vetëm votat e dhëna. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

4. (Mospërputhja ndërmjet Traktatit dhe rregulloreve) Në rast të mospërputhjeve ndërmjet dispozitave të këtij Traktati dhe atyre të rregulloreve, do të mbizotërojnë e para.

Neni 23
Asambleja/Kuvendi

1. (Përbërja)

a) Palët Kontraktuese do të kenë një Kuvend.

b) Çdo Palë Kontraktuese do të përfaqësohet në Kuvend nga një delegat, i cili mund të ndihmohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë alternativë. Secili prej delegatëve mund të përfaqësojë vetëm një Palë Kontraktuese.

2. (Detyrat) Kuvendi do të:

i. merret me çështjet të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e këtij Traktati;

ii. të ndryshojë rregulloret, duke përfshirë formularët e modelit ndërkombëtar;

iii. të përcaktojë kushtet për datën e zbatimit të çdo ndryshimi të përmendur në pikën (ii);

iv. të kryejë funksione të tjera që janë të përshtatshme për zbatimin e dispozitave të këtij Traktati.

3. (Kuorumi)

a) Gjysma e anëtarëve të Kuvendit që janë shtete do të përbëjnë një kuorum (shumicën).

b) Pavarësisht nga nënparagrafi (a), nëse, në çdo seancë, numri i anëtarëve të Kuvendit që janë shtete dhe janë të përfaqësuar, është më pak se gjysma por i barabartë ose më shumë se një e treta e anëtarëve Kuvendit të cilat janë shtete, ky i fundit mund të marrë vendime, por me përjashtim të vendimeve në lidhje me procedurën e tij, të gjitha vendimet e tilla do të hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare do t'ua komunikojë vendimet e përmendura anëtarëve të Kuvendit që janë shtete pjesëmarrëse dhe nuk janë përfaqësuar, dhe i fton ata të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe tremujore nga data e komunikimit. Nëse në skadimin e kësaj periudhe, numri i anëtarëve të tillë që kanë dhënë votën ose abstenimin arrin numrin e anëtarëve i cili mungonte për arritjen e kuoromit në vetë seancën, vendimet e tilla hyjnë në fuqi, me kusht që në të njëjtën kohë shumica e kërkuar ende fiton.

4. (Marrja e vendimeve në Kuvend)

a) Kuvendi do të përpiqet të marrë vendimet e tij me konsensus.

b) Kur një vendim nuk mund të merret me konsensus, çështja në fjalë do të vendoset me votim. Në një rast të tillë:

i. çdo Palë Kontraktuese e cila është shtet do të ketë një votë dhe do të votojë vetëm në emrin e saj; dhe

ii. çdo Palë Kontraktuese që është një organizatë ndërqeveritare mund të marrë pjesë në votim, në vend të shteteve anëtare të saj, me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të saj, të cilat janë palë në këtë Traktat. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë nga shtetet anëtare të saj ushtron të drejtën e votës dhe anasjelltas. Përveç kësaj, asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë nga shtetet e saj anëtare, palë në këtë Traktat, është shtet anëtar i një organizate tjetër ndërqeveritare dhe në rast se ajo organizatë ndërqeveritare merr pjesë në atë votim.

5. (Shumicat)

a) Të kushtëzuara nga nenet 22 (2) dhe (3), vendimet e Kuvendit do të kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura;

b) Në përcaktimin nëse është arritur shumica e kërkuar, do të merren parasysh vetëm votat e hedhura. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota;

6. (Seancat) Kuvendi do të mbledhet me thirrjen e drejtorit të përgjithshëm dhe në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhe dhe në të njëjtin vend si Kuvendi i Përgjithshëm i Organizatës.

7. (Rregullorja e punës) Kuvendi përcakton rregulloren e vet të punës, duke përfshirë rregullat për thirrjen/mbledhjen e seancave të jashtëzakonshme.

Neni 24
Byroja Ndërkombëtare

1. (Detyrat administrative)

a) Byroja Ndërkombëtare do të kryejë detyrat administrative lidhur me këtë Traktat.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë takimet dhe do të sigurojë/shpërndaj me sekretariatit e Kuvendit dhe të komisioneve të tilla të ekspertëve dhe grupeve të punës që mund të krijohen nga Kuvendi.

2. (Takime të ndryshme nga seancat e Kuvendit) Drejtori i përgjithshëm thërret çdo komision dhe grup pune të krijuar nga Kuvendi.

3. (Roli i Byrosë Ndërkombëtare në Kuvend dhe takime të tjera)

a) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij do të marrin pjesë pa të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, sikundër edhe tek komisionet ose grupet e punës të krijuara nga Kuvendi.

b) Drejtori i përgjithshëm ose një anëtar i stafit, i caktuar prej tij, do të jetë sekretar *ex officio* i Kuvendit dhe i komiteteve të grupeve të punës të përmendura në nënparagrafin (a).

4. (Konferenca)

a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Kuvendit, do të bëjë përgatitjet për çdo konferencë rishqyrtimi.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me shtetet anëtare të Organizatës, organizatat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare dhe kombëtare, në lidhje me përgatitjet në fjalë.

c) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij, do të marrin pjesë pa të drejtë vote në diskutime dhe në konferencat e rishqyrtimit.

5. (Detyra të tjera) Byroja Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër që i është caktuar në lidhje me këtë Traktat.

Neni 25
Rishikimet ose ndryshimi

Ky Traktat mund të rishikohet ose ndryshohet vetëm përmes një konferencë diplomatike. Thirrja e çdo konference diplomatike vendoset nga Asambleja.

Neni 26
Bërja palë në traktat

1. (Përshtatshmëria) Entitetet e mëposhtme, mund të nënshkruajnë dhe në përputhje të paragrafëve 2 dhe 3, dhe neneve 28(1) dhe (3), të bëhen palë në këtë Traktat:

i. çdo shtet anëtar i Organizatës, për të cilin markat mund të regjistrohen pranë zyrës së tij përkatëse;

ii. çdo organizatë ndërqeveritare që mban një zyrë, në të cilën markat mund të regjistrohen me efekt në territorin ku zbatohet traktati themelues i organizatës ndërqeveritare, në të gjitha shtetet anëtare të saj ose në ato shtete anëtare që të cilat janë përcaktuar për këtë qëllim në aplikimin përkatës, me kushtin që të gjitha shtetet anëtare të organizatës ndërqeveritare të jenë anëtare të Organizatës;

iii. çdo shtet anëtar i Organizatës, për të cilin regjistrimi i markave mund të bëhet vetëm përmes zyrës së një shteti tjetër të përcaktuar, që është, gjithashtu, anëtar i Organizatës;

iv. çdo shtet anëtar i Organizatës, për të cilin regjistrimi i markave mund të kryhet vetëm përmes zyrës së administruar nga një organizatë ndërqeveritare, anëtare e së cilës është ai shtet;

v. çdo shtet anëtar i Organizatës, për të cilin regjistrimi i markave mund të realizohet vetëm përmes një zyre të përbashkët për një grup shtetesh anëtare të Organizatës.

2. (Ratifikimi ose Aderimi) Çdo entitet i përmendur në paragrafin 1 mund të depozitojë:

i. një instrument ratifikimi, nëse ka nënshkruar këtë Traktat;

ii. një instrument aderimi, nëse nuk e ka nënshkruar këtë Traktat.

3. (Data e hyrjes në fuqi të depozitimit) Data e hyrjes në fuqi të depozitimit të një instrumenti ratifikimi ose aderimi do të jetë:

i. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin (1)(i), data kur depozitohet instrumenti i atij shteti;

ii. në rastin e një organizate ndërqeveritare, data e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit nga ajo organizatë ndërqeveritare;

iii. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin (1)(iii), data kur plotësohet kushti i mëposhtëm: instrumenti i atij shteti është depozituar dhe instrumenti i shtetit tjetër të përcaktuar është depozituar;

iv. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin (1)(iv), data e zbatueshme sipas pikës (ii) të mësipërme;

v. në rastin e një shteti anëtar të një grupi shtetesh, siç përmendet në paragrafin (1)(v), data kur janë depozituar instrumentet e të gjitha shteteve anëtare të grupit.

Neni 27

Zbatimi i TLT 1994 dhe këtij Traktati

1. (Marrëdhëniet midis Palëve Kontraktuese të këtij Traktati dhe TLT 1994) Ky Traktat do të jetë i vetmi i zbatueshëm për sa i përket marrëdhënieve të ndërsjella midis Palëve Kontraktuese që janë palë si në këtë Traktat ashtu edhe në TLT 1994.

2. (Marrëdhëniet midis Palëve Kontraktuese të këtij Traktati dhe Palëve Kontraktuese të TLT 1994 që nuk janë palë në këtë Traktat) Çdo Palë Kontraktuese e cila është palë në këtë Traktat dhe në TLT 1994, do të vazhdojë të zbatojë dispozitat e TLT 1994 në marrëdhëniet me Palët Kontraktuese të TLT 1994 që nuk janë palë në këtë Traktat.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Data e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve

1. (Instrumentet që duhet të merren parasysh) Për qëllimet e këtij neni, vetëm instrumentet e ratifikimit ose aderimit të depozituara nga entitetet e përmendura në nenin 26(1) dhe që kanë një datë hyrjeje në fuqi do të merren parasysh sipas nenit 26(3).

2. (Hyrja në fuqi e Traktatit) Ky Traktat do të hyjë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose aderimit nga dhjetë shtete ose organizata ndërqeveritare, të përmendura në nenin 26(1)(ii).

3. (Hyrja në fuqi e ratifikimeve dhe aderimeve pas hyrjes në fuqi të Traktatit) Çdo entitet që nuk përfshihet nga paragrafi 2 do të bëhet palë në këtë Traktat tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 29

Rezervat

1. (Marka të veçanta) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të shpallë përmes një rezerve se, pavarësisht nga nenet 2(1) dhe (2)(a), asnjë nga dispozitat e neneve 3(1), 5, 7, 8(5), 11 dhe 13 nuk

do të zbatohet për markat e asociuara, markat mbrojtëse ose markat derivuese. Një rezervë e tillë duhet të specifikojë dispozitat e përmendura më sipër, për të cilat rezerva ka lidhje.

2. (Regjistrimi i kategorive të shumëfishta) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare, legjislacioni i së cilës në datën e miratimit të këtij Traktati parashikon regjistrimin për kategori të shumta për mallra dhe për klasa të shumta shërbimesh, mund, gjatë aderimit në këtë Traktat, të deklarojë përmes një rezerve se dispozitat e nenit 6 nuk do të zbatohen.

3. (Shqyrtimi thelbësor me rastin e rinovimit) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të deklarojë, përmes një rezerve, se pavarësisht nga neni 13(4), zyra mund të shqyrtojë thelbësisht një regjistrim me rastin e rinovimit të parë të një regjistrimi që mbulon shërbimet, me kusht që një shqyrtim i tillë të kufizohet në eliminimin e regjistrimeve të shumta të bazuara në aplikime të dorëzuara gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit të atij shteti ose organizate, i cili ka futur, përpara hyrjes në fuqi të këtij Traktati, mundësinë e regjistrimit të markave të shërbimeve.

4. (Të drejta të caktuara të licencëmarrësit) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të deklarojë, përmes një rezerve, që pavarësisht nga neni 19(2), kërkohet regjistrimi i licencës si kusht për çdo të drejtë që mund të ketë licencëmarrësi, sipas ligjit të atij shteti ose organizate ndërqeveritare, për t'u bashkuar në procedurat për shkelje të iniciuara nga mbajtësi ose për të marrë, përmes këtyre procedurave, dëmshpërblime që rrjedhin nga shkelja e markës që është objekt i licencës.

5. (Modalitetet) Çdo rezervë sipas paragrafëve 1, 2, 3 ose 4, duhet të bëhet përmes një deklarate që shoqëron instrumentin e ratifikimit ose aderimin në këtë Traktat nga shteti ose organizata ndërqeveritare përkatëse që e bën rezervën.

6. (Tërheqja) Çdo rezervë, në përputhje me paragrafët 1, 2, 3 ose 4, mund të tërhiqet në çdo kohë.

7. (Ndalimi i rezervave të tjera) Asnjë rezervë tjetër ndaj këtij Traktati, përveç rezervave të lejuara sipas paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4, nuk do të lejohet.

Neni 30

Denoncimi i Traktatit

1. (Njoftimi) Çdo Palë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Traktat me anë të një njoftimi drejtuar drejtorit të përgjithshëm.

2. (Data e hyrjes në fuqi) Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit nga data kur drejtori i përgjithshëm ka marrë njoftimin. Kjo nuk do të ndikojë në zbatimin e këtij Traktati për asnjë aplikim në pritje ose markë të regjistruar, në lidhje me Palën Kontraktuese që po e denoncon, në momentin e skadimit të periudhës njëvjeçare të përmendur, me kusht që Pala Kontraktuese që denoncon mund, pas skadimit të periudhës njëvjeçare, të ndërpresë zbatimin e këtij Traktati për çdo regjistrim, duke filluar nga data kur ky regjistrim duhet të rinovohet.

Neni 31

Gjuhët e Traktatit; nënshkrimi

1. (Tekstet origjinale; tekstet zyrtare)

a) Ky Traktat do të nënshkruhet në një tekst origjinal të vetëm në gjuhët anglisht, arabisht, kineze, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, dhe të gjitha tekstet do të kenë vlefshmëri të barabartë.

b) Një tekst zyrtar në një gjuhë që nuk përmendet në nënparagrafin (a) dhe që është gjuhë zyrtare e një Pale Kontraktuese, do të përgatitet nga drejtori i përgjithshëm pas konsultimit me Palën Kontraktuese përkatëse dhe çdo palë tjetër kontraktuese të interesuar.

2. (Afati për nënshkrim) Ky Traktat do të mbetet i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës për një periudhë prej një viti pas datës së miratimit të tij.

Neni 32
Depozitari

Drejtori i përgjithshëm do të jetë depozitari i këtij Traktati.

**REZOLUTA NGA KONFERENCA DIPLOMATIKE PLOTËSUESE E TRAKTATIT TË
SINGAPORIT MBI LIGJIN E MARKAVE TREGTARE**

1. Konferenca diplomatike për miratimin e një traktati të rishikuar mbi të drejtën e markave tregtare, e mbajtur në Singapor, në mars 2006, u dakordësua që Traktati i miratuar nga Konferenca do të quhej “Traktati i Singaporit për të Drejtën e Markave Tregtare” (që këtej e tutje referuar si “Traktati”).

2. Gjatë miratimit të Traktatit, Konferenca Diplomatiqe u dakordësua që fjalët “Procedurë përpara zyrës” në nenin 1(viii) nuk do të mbulonin procedurat juridike sipas legjislacionit të Palëve Kontraktuese.

3. Duke pranuar faktin se Traktati parashikon procedura formale të dobishme dhe efikase të markës tregtare për Palët Kontraktuese, Konferenca Diplomatiqe kuptoi se nenet 2 dhe 8, përkatësisht nuk impononin asnjë detyrim për Palët Kontraktuese, lidhur me:

i. regjistrimin e llojeve të reja të markave, siç përmendet në rregullin 3, paragrafët 4, 5 dhe 6 të rregullores; ose

ii. të verë në zbatim sisteme të regjistrimit elektronik ose sisteme të tjera automatike.

Çdo Palë Kontraktuese do të ketë mundësinë të vendosë nëse dhe kur do të parashikojë regjistrimin e llojeve të reja të markave të sipërpërmendura.

4. Me synimin për të lehtësuar zbatimin e Traktatit në vendet në zhvillim dhe në vendet më pak të zhvilluara (LDC), Konferenca Diplomatiqe i kërkoi Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe Palëve Kontraktuese të ofrojnë ndihmë teknike shtesë dhe të përshtatshme që ka të bëjë me teknologjinë, anën ligjore dhe forma të tjera mbështetjeje për të forcuar kapacitetin institucional të atyre vendeve për sa i përket zbatimit të Traktatit dhe për t’u mundësuar atyre vendeve të përfitojnë plotësisht nga dispozitat e Traktatit.

5. Një ndihmë e tillë duhet të marrë parasysh nivelin e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik të vendeve përfituese. Mbështetja nga pikëpamja teknologjike, do të ndihmonte në përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të këtyre vendeve, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e hendekut teknologjik midis Palëve Kontraktuese. Konferenca Diplomatiqe vuri në dukje se disa vende theksuan rëndësinë e Fondit të Solidaritetit Digjital (FSD) si i rëndësishëm për zbutjen e ndarjes digjitale.

6. Për më tepër, me hyrjen në fuqi të Traktatit, Palët Kontraktuese do të marrin përsipër të shkëmbejnë dhe ndërveprojnë në baza shumëpalëshe, informacionin dhe përvojat lidhur me aspektet ligjore, teknike dhe institucionale për sa i përket zbatimit të Traktatit dhe mënyrën për shfrytëzimin e plotë të mundësive dhe përfitimeve që burojnë prej tyre.

7. Konferenca Diplomatiqe, duke njohur situatën dhe nevojat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara, u dakordësua që VPZ-ve t’u jepet trajtim i veçantë dhe i ndryshëm për zbatimin e Traktatit, si më poshtë:

a) Vendet më pak të zhvilluara do të jenë përfituesit kryesorë dhe kryesorë të ndihmës teknike nga Palët Kontraktuese dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO);

b) kjo ndihmë teknike përfshin elementet si në vijim:

i. ndihmë në krijimin e kuadrit ligjor për zbatimin e Traktatit;

ii. informimin, edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, lidhur me ndikimin e aderimit në Traktat;

iii. ndihmë në rishikimin e praktikave dhe procedurave administrative të autoriteteve kombëtare të regjistrimit të markave tregtare;

iv. ndihmë në krijimin e fuqisë punëtore të nevojshme të trajnuar dhe objekteve të zyrave të IP-së, duke përfshirë kapacitetin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të zbatuar në mënyrë efikase Traktatin dhe rregulloret e tij.

8. Konferenca Diplomatike i kërkoi Kuvendit të mbikëqyrë dhe vlerësojë në çdo seancë të zakonshme, ecurinë për sa i takon përpjekjeve që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përfitimet që rrjedhin nga ky zbatim.

9. Konferenca Diplomatike u dakordësua që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Traktati, duhet të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimit dhe ndërmjetësimit nën kujdesin e drejtorit të përgjithshëm.

RREGULLORET SIPAS TRAKTATIT TË SINGAPORIT PËR TË DREJTËN E MARKAVE TREGTARE

LISTA E RREGULLOREVE

Rregullorja 1: Shprehjet e shkurtuara

Rregullorja 2: Mënyra e shënimit të emrave dhe adresave

Rregullorja 3: Detajet lidhur me aplikimin

Rregullorja 4: Detajet në lidhje me përfaqësimin dhe adresën për shërbim

Rregullorja 5: Detajet për sa i takon datës së depozitimit

Rregullorja 6: Detajet në lidhje me komunikimet

Rregullorja 7: Mënyra e Identifikimit të një aplikimi pa kërkesën e tij

Numri

Rregullorja 8: Detaje në lidhje me kohëzgjatjen dhe rinovimin

Rregullorja 9: Masat lehtësuese në rast të moszbatimit të afateve kohore

Rregullorja 10: Kushtet për sa i përket regjistrimit të një licence ose për amendimin dhe anulimin e regjistrimit të një licence

Rregullorja 1 Shprehje të shkurtuara

1. (Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në rregullore) Për qëllimet e këtyre rregulloreve, përveç nëse shprehimisht parashtrohet ndryshe:

i. “Traktati” nënkupton Traktatin e Singaporit mbi Ligjin e Markave Tregtare;

ii. “Neni” i referohet nenit të posaçëm të Traktatit;

iii. “Licencë ekskluzive” nënkupton një licencë që i jepet vetëm një të licencuari dhe e cila e përjashton mbajtësin nga përdorimi i markës dhe nga dhënia e licencave për çdo individ tjetër;

iv. “Licencë e vetme” do të thotë një licencë që i jepet vetëm një të licencuari dhe që e përjashton mbajtësin nga dhënia e licencave për çdo person tjetër, por nuk e përjashton mbajtësin nga përdorimi i markës;

v. “Licencë joekskluzive që nuk i gëzon të gjitha të drejtat” nënkupton një licencë që nuk e përjashton mbajtësin nga përdorimi i markës ose nga dhënia e licencave për ndonjë individ tjetër.

2. (Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në Traktat) Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në nenin 1 për qëllimet e Traktatit do të kenë të njëjtin kuptim për qëllimet e këtyre rregulloreve.

Rregullorja 2 Mënyra e shënimit të emrave dhe adresave

1. (Emrat)

a) Kur duhet të tregohet emri i një individi, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë:

i. kur individi është person fizik, të jetë emri që do të shënohet, mbiemri ose emri kryesor, emri ose emrat dytësor të atij personi dhe emri që do të shënohet të jetë sipas zgjedhjes së personit në fjalë, emri ose emrat të cilët përdoren zakonisht nga vetë individi;

ii. kur personi është person juridik, emri që do të tregohet të jetë ai përcaktimi i plotë zyrtar i personit juridik;

b) Në rastin kur do të tregohet emri i një përfaqësuesi që është një firmë ose ortakëri, çdo Palë Kontraktuese do të pranojë si dëshmi të emrit treguesin, të cilin firma ose ortakëria përdor zakonisht.

2. (Adresat)

a) Kur adresa e një personi duhet të tregohet, çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që adresa të tregohet në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e zakonshme për dërgimin e shpejtë postar në adresën përkatëse. Në çdo rast, të përbëhet nga të gjitha njësitë administrative përkatëse, duke përfshirë numrin e shtëpisë ose të ndërtesës, nëse ka një të tillë.

b) Kur një komunikim në zyrën e një Pale Kontraktuese është në emër të dy ose më shumë personave me adresa të ndryshme, ajo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një komunikim i tillë të paraqesë një adresë të vetme për korrespondencë.

c) Treguesi i një adrese mund të përmbajë një numër telefoni, një numër telefaksi dhe një adresë *email*-i për qëllime të korrespondencës, një adresë të ndryshme nga adresa e paraqitur në nënparagrafin (a).

d) Nënparagrafët (a) dhe (c) do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për sa i përket adresave për shërbim.

3. (Mjete të tjera identifikimi) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një komunikim në Zyrë të tregojë numrin ose mjetet e tjera të identifikimit, nëse ka, me të cilin aplikanti, mbajtësi, përfaqësuesi ose personi i interesuar është regjistruar në zyrën e saj. Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të refuzojë një komunikim për shkak të mospërmbushjes së ndonjë kërkesë të tillë, me përjashtim të aplikimeve të paraqitura në formë elektronike.

4. (Shkrimi i shtypit që do të përdoret) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që çdo tregues i përmendur në paragrafët 1 deri në 3 të jetë në skriptin e përdorur nga zyra.

Rregullorja 3

Detaje në lidhje me aplikimin

1. (Shkronjat standarde) Kur zyra e një Pale Kontraktuese përdor karaktere (shkronja dhe numra) që ajo i konsideron si standarde dhe kur aplikimi përmban një deklaratë, e cila tregon se aplikanti dëshiron që marka të regjistrohet dhe publikohet me shkronja standarde të përdorura nga zyra. Në këtë mënyrë, kjo e fundit do ta regjistrojë dhe publikojë atë markë me shkronja të tilla standarde.

2. (Ngjyra si tipar dallues) Kur aplikimi përmban një deklaratë e cila thotë se aplikanti dëshiron të pretendojë ngjyrën si tipar dallues të markës, zyra mund të kërkojë që aplikimi të paraqesë emrin, kodin e ngjyrës ose ngjyrave të pretenduara, një tregues për sa i përket atyre dhe të pjesëve kryesore të markës të cilat janë pjesë përbërëse e asaj ngjyrë.

3. (Numri i kopjeve)

a) Kur aplikimi nuk përmban një deklaratë për arsye se aplikanti dëshiron të përcaktojë ngjyrën si një tipar dallues të markës, një Palë Kontraktuese nuk mund të kërkojë më shumë se:

i. pesë kopje të markës bardh e zi ku aplikimi, sipas ligjit të asaj Pale Kontraktuese, nuk mund të përmbajë një deklaratë e cila tregon se aplikanti dëshiron që marka të regjistrohet dhe publikohet me shkronjat standarde të përdorura nga zyra e kësaj Pale Kontraktuese;

ii. një kopje bardhë e zi të markës, ku kërkesa përmban një deklaratë e cila dëshmon se aplikanti dëshiron që marka të regjistrohet dhe të publikohet me karakteret standarde të përdorura nga zyra e asaj Pale Kontraktuese.

b) Kur aplikimi përmban një deklaratë, me qëllim që aplikanti nëse dëshiron të përcaktojë ngjyrën si tipar dallues të markës, Pala Kontraktuese nuk mund të kërkojë më shumë se pesë kopje të markës bardh e zi dhe pesë kopje të markës me ngjyra.

4. (Markë tredimensionale)

a) Kur kërkesa përmban një deklaratë që thotë se marka është një shenjë tridimensionale, kopja e markës do të përbëhet nga një kopje grafike ose fotografike dydimensionale.

b) Kopja e paraqitur sipas nënparagrafit (a), mundet që sipas dëshirës së aplikantit, të përbëhet nga një fotografi e vetme e markës ose nga disa fotografi të ndryshme të markës.

c) Kur zyra vlerëson se kopja e markës së paraqitur nga aplikanti sipas nënparagrafit (a) nuk tregon mjaftueshëm të dhënat e markës tridimensionale, ajo mund ta ftojë aplikantin të dorëzojë, brenda një afati të arsyeshëm kohor të caktuar, deri në gjashtë fotografi të ndryshme të markës dhe/ose një përshkrim me fjalë të asaj marke.

d) Kur zyra konsideron se pikëpamjet e ndryshme dhe/ose përshkrimi i markës të përmendur në nënparagrafin (c) ende nuk tregojnë mjaftueshëm të dhënat e markës tridimensionale, ajo mund të ftojë aplikantin të japë, brenda një afati të arsyeshëm afati kohor, të fiksuar në ftesë, një model të markës.

e) Pavarësisht nga nënparagrafët (a) deri (d), një riprodhim mjaft i qartë që tregon karakterin tridimensional të markës në një pamje do të jetë i mjaftueshëm për dhënien e një date depozitimi.

f) Paragrafi (3)(a)(i) dhe (b) zbatohet *mutatis mutandis*.

5. (Markë Holografi) Kur aplikimi përmban një deklaratë e cila parashtrohet se marka është shenjë hologrami, simboli i markës përbëhet nga një ose disa pamje të kësaj të fundit që kap efektin holografik në tërësinë e saj. Në rast se zyra konsideron se pamja ose imazhet e paraqitura nuk kapin efektin holografik në tërësinë e tij, ajo mund të kërkojë parashttrimin e pamjeve shtesë. Zyra, gjithashtu, mund t'i kërkojë aplikantit të japë një përshkrim të markës holografike.

6. (Markë lëvizëse) Kur aplikimi përmban një deklaratë që thotë se marka është një shenjë lëvizëse, simboli i markës, sipas zgjedhjes së Zyrës, përbëhet nga një shëmbëlltyrë ose një seri imazhesh të palëvizshme apo në lëvizje, të cilët përshkruajnë lëvizjen. Kur Zyra gjykon se shëmbëlltyra ose imazhet e paraqitura nuk përshkruajnë lëvizje, mund të kërkojë paraqitjen e imazheve shtesë. Zyra mund po ashtu të kërkojë, që aplikanti të paraqesë një përshkrim i cili shpjegon lëvizjen.

7. (Markë me ngjyra) Kur aplikimi përmban një deklaratë që tregon se marka është një shenjë me ngjyrë në vetvete ose një kombinim ngjyrash pa konture të skicuara, kopja e markës do të përbëhet nga një mostër e ngjyrës ose ngjyrave. Zyra mund të kërkojë një përcaktim të ngjyrës ose ngjyrave duke përdorur emrat e tyre të zakonshëm. Zyra mund, po ashtu, të parashtrojë një kërkesë për të përshkruar se si është ngjyra ose ngjyrat janë aplikuar në mallra ose përdoren në për sa i përket shërbimeve. Zyra mund të kërkojë më tej një tregues të ngjyrës ose ngjyrave me një kod të njohur të këtyre të fundit, të zgjedhur nga aplikanti dhe të pranuar nga zyra.

8. (Markë pozicioni) Kur aplikimi përmban një deklaratë që tregon se marka është një markë pozicioni, riprodhimi i markës përbëhet nga një pamje e vetme e markës që tregon pozicionin e saj në produkt. Zyra mund të kërkojë që të tregohet ajo çështje, për të cilën nuk kërkohet mbrojtje. Kjo e fundit, mund gjithashtu një përshkrim që shpjegon pozicionin e markës lidhur me produktin.

9. (Markë Zanore) Kur aplikimi përmban një deklaratë që tregon se marka është një shenjë zanore, simboli i markës, sipas zgjedhjes së zyrës, përbëhet nga një sistem notash muzikore në një strofë, një përshkrim të tingullit i cili përbën shenjën, një regjistrim i ngjashëm apo regjistrim digjital i atij tingulli, ose ndonjë kombinim midis tyre.

10. (Markë e cila përbëhet nga një tregues jo i dukshëm, përveç markës zanore) Kur aplikimi përmban një deklaratë që tregon se marka përbëhet nga një shenjë e padukshme, përveç markës zanore, Pala Kontraktuese mund të kërkojë një ose më shumë simbole të markës, një tregues të llojit të markës dhe detajet për sa i takon markës, siç përcaktohet nga ligji për Palët Kontraktuese.

11. (Tejshkronjëzimi i markës) Për qëllimet e nenit 3(1)(a)(xiii), kur marka përbëhet nga ose ka përmbajtje në shkrim të ndryshme nga shkrimi i shtypit përdorur prej zyrës, ose numra të shprehur në shifra ndryshe nga shifrat e përdorura nga zyra, mund të kërkohet një tejshkronjëzim i një përmbajtjeje të tillë, së bashku me shkrimin e shtypit dhe shifrave/simboleve të përdorura nga kjo e fundit.

12. (Përkthimi i markës) Për qëllimet e nenit 3(1)(a)(xiv), kur marka përbëhet ose përmban një term ose fjalë të një gjuhë të ndryshme nga gjuha, ose një nga gjuhët të cilat pranohet nga zyra, mund të kërkohet përkthim i asaj fjale ose atyre fjalëve në atë gjuhë, ose në një nga gjuhët përkatëse.

13. (Afati kohor për dhënien e provave të përdorimit aktual të markës) Afati kohor i përmendur në nenin 3(3) nuk do të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj i llogaritur nga data e lejimit të aplikimit nga zyra e Palës Kontraktuese ku është depozituar ajo kërkesë. Aplikanti ose mbajtësi do të ketë të drejtën për një zgjatje të këtij afati kohor, në përputhje të kushteve të parashikuara nga ligji i asaj Pale Kontraktuese, me afat kohor prej të paktën gjashtë muaj secili, deri në një zgjatje përfundimtare prej të paktën dy vite e gjysmë.

Rregullorja 4

Detaje në lidhje me përfaqësimin dhe adresën për shërbim

1. (Adresa ku caktohet një përfaqësues) Kur emërohet një përfaqësues, një Palë Kontraktuese do të konsiderojë adresën e atij përfaqësuesi si adresën e dërgimit.

2. (Adresa ku nuk është caktuar asnjë përfaqësues) Kur nuk emërohet përfaqësues dhe një aplikant, mbajtës ose individ tjetër i interesuar ka dhënë si adresë të tij një adresë në territorin e Palës Kontraktuese, ajo Palë Kontraktuese do ta konsiderojë këtë të fundit si adresë për shërbim.

3. (Afati kohor) Afati kohor i përmendur në nenin 4(3)(d) do të përllogaritet nga data e marrjes së komunikimit të përmendur në atë nen nga zyra e Palës Kontraktuese të interesuar dhe nuk do të jetë më e vogël se një muaj, kur adresa e personi në emër të të cilit është bërë komunikimi është në territorin e asaj Pale Kontraktuese dhe jo më pak se dy muaj kur një adresë e tillë është jashtë territorit të asaj Pale Kontraktuese.

Rregullorja 5

Detaje në lidhje me datën e depozitimit

1. (Procedura në rast të mospërputhjes me kërkesat) Nëse aplikimi në kohën e marrjes së tij nga zyra, nuk përputhet me ndonjë nga kërkesat e zbatueshme të nenit 5(1)(a) ose (2) (a), zyra do ta ftojë menjëherë aplikantin që të përmbushë këto kërkesa brenda një afati kohor të treguar në ftesë, afati i të cilit do të jetë së paku një muaj nga data e ftesës në rast se adresa e aplikantit është në territorin e Palës Kontraktuese të interesuar dhe të paktën dy muaj kur adresa e aplikantit është jashtë territorit të Palës Kontraktuese në fjalë. Njoftimi me ftesën mund të jetë subjekt i pagesës së një tarife të veçantë. Edhe nëse zyra nuk e dërgon ftesën në fjalë, kërkesat e përmendura mbeten të paprekura.

2. (Data e dorëzimit në rast korrigjimi) Nëse, brenda afatit kohor të treguar në ftesë, aplikanti përmbush ftesën e përmendur në paragrafin 1 dhe paguan çdo tarifë speciale të kërkuar, data e depozitimit do të jetë data në të cilat të gjithë treguesit dhe elementet e kërkuara të përmendura në nenin 5(1)(a) janë marrë nga zyra dhe kur është e zbatueshme, tarifat e kërkuara të përmendura në nenin 5(2)(a) i janë paguar zyrës. Në të kundërt, aplikimi do të konsiderohet sikur të mos ishte paraqitur.

Rregullorja 6

Detaje në lidhje me komunikimet

1. (Treguesit të cilët shoqërojnë nënshkrimin e komunikimit me shkrim) Çdo palë kontraktuese mund të kërkojë që nënshkrimi i personit fizik i cili e nënshkruan të shoqërohet me:
 - i. një tregues me shkronja të mbiemrit ose emrit kryesor dhe emrave dytësorë të atij personi, sikundër edhe sipas zgjedhjes së atij personi, të emrit ose emrave të përdorur zakonisht nga personi në fjalë;
 - ii. një tregues për cilësinë në të cilën ai individ e ka nënshkruar, kur një cilësi e tillë nuk është e dukshme nga leximi i komunikimit.
2. (Data e nënshkrimit) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që një nënshkrim të shoqërohet me një tregues të datës në të cilën është bërë nënshkrimi. Kur ky tregues kërkohet por nuk jepet, data në të cilën nënshkrimi konsiderohet se është kryer do të jetë data në të cilën dokumenti që mban nënshkrimin është marrë nga zyra ose nëse Pala Kontraktuese e lejon këtë, një datë më të hershme se data e fundit.
3. (Nënshkrimi i dokumenteve me shkrim) Kur komunikimi me zyrën e një Pale Kontraktuese është me shkrim dhe kërkohet një nënshkrim, ajo Palë Kontraktuese:
 - i. sipas pikës (iii), do të pranojë nënshkrimin me shkrim dore;
 - ii. mund të lejojë që në vend të një nënshkrimi të shkruar me dorë, të përdoren forma të tjera të nënshkrimit, të tilla si një nënshkrim i printuar ose i stampuar, ose përdorimi i një vule me etikete dhe me barkod;
 - iii. mundet kur personi fizik që nënshkruan dokumentin është shtetas i Palës Kontraktuese dhe adresa e personit përkatës është në territorin e saj, ose kur personi juridik në emër të së cilit është nënshkruar dokumenti është i organizuar sipas ligjit të tij dhe ka një vendbanim, apo një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare në territorin e saj, kërkon që të përdoret një vulë në vend të një nënshkrimi me shkrim dore.
4. (Nënshkrimi i dokumenteve me shkrim të dorëzuara nga mjetet elektronike të transmetimit) Një palë kontraktuese e cila parashikon që dokumentet të dorëzohen me shkrim në mënyra përmes përçimit në mënyrë elektronike, do të konsiderojë çdo dokument të tillë të nënshkruar nëse një paraqitje grafike e një nënshkrimi të pranuar nga ajo Kontraktues Pala sipas paragrafit 3, paraqitet në dokument siç është marrë.
5. (Origjinali i një dokumenti me shkrim të dorëzuar nga mjetet elektronike të transmetimit) Një palë kontraktuese e cila parashikon që dokumentet me shkrim të dorëzohen me mjete elektronike të transmetimit, mund të kërkojë që të depozitohet origjinali i çdo dokumenti të tillë:
 - i. me zyrën e shoqëruar nga një dokument, i cili e identifikon atë transmetim të mëparshëm; dhe
 - ii. brenda një afati kohor i cili do të jetë së paku një muaj nga data në të cilën zyra është vënë në dijeni përmes mjeteve elektronike të transmetimit.
6. (Vërtetimi i komunikimeve në formë elektronike) pala kontraktuese e cila lejon paraqitjen e komunikimeve në formë elektronike, mund të kërkojë që çdo komunikim i tillë të vërtetohet nëpërmjet një sistemi të vërtetimit elektronik, ashtu siç përcaktohet nga ajo Palë Kontraktuese.
7. (Data e marrjes) Secila Palë Kontraktuese do të jetë e lirë të përcaktojë rrethanat në të cilat, marrja e një dokumenti ose shlyerja e një tarife do të konsiderohet se përbën pagesë të zyra, në rastet kur dokumenti është marrë, ose pagesa është bërë në të vërtetë për:
 - i. një degë ose filial të zyrës;
 - ii. një zyrë kombëtare në emër të zyrës së Palës Kontraktuese, në rast se Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare e përmendur në nenin 26(1)(ii);
 - iii. një shërbim postar zyrtar;
 - iv. një shërbim shpërndarjeje, ose një agjenci, të specifikuar nga Pala Kontraktuese;
 - v. një adresë e ndryshme nga adresat e caktuara prej zyrës.
8. (Regjistrimi elektronik) Në përputhje të paragrafit 7, ku një Palë Kontraktuese parashikon paraqitjen e një komunikimi në formë elektronike ose me përmes mjeteve elektronike të transmetimit

dhe komunikimi është paraqitur në këtë mënyrë, data në të cilën zyra e asaj Pale Kontraktuese e merr komunikimin në një formë të tillë ose me mjete të tilla, do të përbëjë datën e marrjes së këtij të fundit.

Rregulli 7

Mënyra e identifikimit të një aplikimi pa numrin e tij të aplikimit

1. (Mënyra e identifikimit) Kur kërkohet që një aplikim të identifikohet me numrin e aplikimit, por kur një numër i tillë ende nuk është lëshuar ose nuk është i njohur për aplikantin, ose përfaqësuesin e tij, ky i fundit do të konsiderohet i identifikuar nëse paraqiten si në vijim:

- i. numri i përkohshëm i aplikimit, nëse ka, i parashtruar nga zyra;
- ii. një kopje e aplikimit;
- iii. një parashtrim i markës, i shoqëruar me një tregues të datës në të cilën, me dijeninë e plotë të aplikantit ose përfaqësuesit, kërkesa është pranuar nga zyra, duke i bashkëngjitur një numër identifikimi kërkesës, e cila është paraqitur nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.

2. (Ndalimi i kërkesave të tjera) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera, përveç atyre të përmendura në paragrafin 1, të përmbushen në mënyrë që një aplikim të identifikohet kur numri i aplikimit të tij nuk është lëshuar ende, ose nuk i është bërë e ditur aplikantit ose përfaqësuesit të tij.

Rregullorja 8

Detaje në lidhje me kohëzgjatjen dhe rinovimin

Për qëllimet e nenit 13(1)(c), periudha gjatë së cilës mund të paraqitet kërkesa për rinovim dhe mund të paguhet tarifa e rinovimit, do të fillojë të paktën gjashtë muaj përpara datës në të cilën duhet rinovimi dhe do të përfundojë në gjashtë muajt më të hershëm pas kësaj date. Nëse kërkesa për rinovim paraqitet dhe/ose tarifat e rinovimit paguhën pas datës në të cilën duhet të bëhet rinovimi, çdo Palë Kontraktuese mund të vendosë pranimin e kërkesës për rinovim përmes pagesës së një shtese.

Rregullorja 9

Masat lehtësuese në rast të moszbatimit të afateve kohore

1. (Kërkesat në lidhje me zgjatjen e afateve kohore sipas nenit 14(2)(i))

Një Palë Kontraktuese që parashikon zgjatjen e një afati kohor sipas nenit 14(2)(i) do të zgjasë afatin për një periudhë të arsyeshme kohore nga data e paraqitjes së kërkesës për zgjatje të afatit dhe mund të kërkojë që kërkesa:

- i. të përmbajë një identifikim të palës e cila ka paraqitur kërkesën, aplikimin përkatës ose numrin e regjistrimit, afatin kohor në fjalë; dhe
- ii. të depozitohet brenda një afati kohor i cili nuk duhet të jetë më pak se dy muaj nga data e skadimit të afatit kohor në fjalë.

2. (Kërkesat në lidhje me përpunimin e vazhdueshëm sipas nenit 14(2)(ii)) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për përpunim të vazhdueshëm sipas nenit 14(2)(ii):

- i. të përmbajë një identifikim të palës e cila ka paraqitur kërkesën, aplikimin përkatës ose numrin e regjistrimit së bashku me afatin kohor në fjalë; dhe
- ii. të depozitohet brenda një afati kohor i cili nuk duhet të jetë më pak se dy muaj nga data e skadimit të afatit kohor në fjalë. Akti i hequr do të përfundojë brenda së njëjtës periudhë ose, kur Pala Kontraktuese e parashikon këtë së bashku me kërkesën.

3. (Kërkesat në lidhje me rivendosjen e të drejtave sipas nenit 14(2)(iii))

a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për rivendosjen e të drejtave sipas nenit 14(2)(iii):

i. të përmbajë një identifikim të palës kërkuese, kërkesën përkatës ose numrin e regjistrimit dhe afatin kohor në fjalë; dhe

ii. të përcaktojë faktet dhe provat në mbështetje të arsyeve të mosveprimit në përputhje me afatin kohor në fjalë.

b) Kërkesa për rivendosjen e të drejtave do të depozitohet në zyrë brenda një afati të arsyeshëm kohor, kohëzgjatja e të cilit do të përcaktohet nga Pala Kontraktuese nga data e heqjes së shkakut të moszbatimit të afatit kohor në fjalë. Akti i hequr do të përfundojë brenda së njëjtës periudhë ose, kur Pala Kontraktuese e parashikon këtë, së bashku me kërkesën.

c) Një Palë Kontraktuese mund të parashikojë një afat kohor maksimal për përmbushjen e kërkesave sipas nënparagrafëve “a” dhe “b”, jo më pak se gjashtë muaj nga data e skadimit të afatit kohor në fjalë.

4. (Përfashtimet sipas nenit 14(3)) Përfashtimet e përmendura në nenin 14(3) janë rastet e moszbatimit të një afati kohor:

i. për të cilat është dhënë tashmë një masë lehtësuese/korrigjuese sipas nenit 14(2);

ii. depozitimin e një kërkesë, lidhur me një masë lehtësuese sipas nenit 14;

iii. për pagesën e një tarife rinovimi;

iv. për një veprim përpara një bordi apeli ose organi tjetër rishikues të krijuar në kuadër të zyrës;

v. për një padi në procedurat *inter partes*;

vi. për depozitimin e deklaratës së përmendur në nenin 3(1)(a)(vii) ose deklaratën e përmendur në nenin 3(1)(a)(viii);

vii. për paraqitjen e një deklarate e cila, sipas ligjit të Palës Kontraktuese, mund të vendosë një datë të re depozitimi për një kërkesë në pritje; dhe

viii. për korrigjimin ose shtimin e një kërkesë prioritare.

Rregullorja 10

Kushtet lidhur me kërkesën për regjistrimin e një licence, për ndryshimin ose anulimin e regjistrimit të licencës

1. (Përmbajtja e kërkesës)

a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një licence, sipas nenit 17(1) të përmbajë disa ose të gjithë prej treguesve të mëposhtëm:

i. emrin dhe adresën e mbajtësit;

ii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;

iii. kur mbajtësi ka një adresë për shërbim, adresën e tij;

iv. emrin dhe adresën e të licencuarit;

v. kur i licencuari ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

vi. kur i licencuari ka një adresë për shërbimin, adresën përkatëse;

vii. emrin e një shteti në të cilin i licencuari është shtetas, nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti të caktuar, emrin e shtetit në të cilin i licencuari ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka dhe emrin e shtetit në të cilin i licencuari ka një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare, nëse ka;

viii. kur mbajtësi ose i licencuari është një person juridik, natyra ligjore e personit juridik dhe e shtetit, dhe kur është e zbatueshme njësi territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit të të cilit është organizuar subjekti juridik në fjalë;

ix. numrin e regjistrimit të markës e cila është objekt i licencës;

x. emrat e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është dhënë licenca, të grupuara sipas kategorive të klasifikimit të Nisës, ku secili grup paraprihet nga numri i kategorisë së atij klasifikimi

të cilit i përket ai grup mallrash ose shërbimesh dhe të paraqitura sipas renditjes së kategorive të klasifikimit në fjalë;

xi. nëse licenca është një licencë (ekskluzive) e cila gëzon të gjitha të drejtat, një licencë e cila nuk i gëzon të gjitha të drejtat (joekskluzive) ose një licencë e veçantë;

xii. aty ku është e zbatueshme, licenca ka të bëjë vetëm me një pjesë të territorit të mbuluar nga regjistrimi, së bashku me një tregues të shprehur qartë të asaj pjese të territorit;

xiii. kohëzgjatja e licencës.

b) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence sipas nenit 18(1) të përmbajë disa ose të gjitha nga treguesit, ose elementet e mëposhtme:

i. treguesit e specifikuar në pikat (i) deri (ix) të nënparagrafit (a);

ii. kur ndryshimi ose anulimi ka të bëjë me ndonjë nga treguesit ose elementet e specifikuara në nënparagrafin (a), natyra dhe qëllimi/fusha e veprimit të veprimtarisë së amendamentit ose anulimit që do të regjistrohet.

2. (Dokumentet mbështetëse për regjistrimin e një licence)

a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një licence të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës e cila ka bërë kërkesën, nga një element, nga sa vijon:

i. një ekstrakt të kontratës së licencës i cili përcakton palët dhe të drejtat që licencohen, i vërtetuar nga një noter ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, një ekstrakt origjinal të kontratës; ose

ii. një deklaratë të pacertifikuar të licencës, përmbajtja e së cilës korrespondon me formularin e deklaratës së licencës, të parashikuar në rregullore dhe të nënshkruar si nga mbajtësi ashtu edhe nga i licencuari.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë që çdo bashkëpronar, i cili nuk është palë në kontratën e licencës të japë pëlqimin e tij të shprehur për licencën në një dokument të nënshkruar prej saj.

3) (Dokumentet mbështetëse për ndryshimin e regjistrimit të një licence)

a) Një Palë Kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshimin e regjistrimit të një licence të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës kërkuuese, nga një nga sa vijon:

i. dokumente që vërtetojnë ndryshimin e kërkuar të regjistrimit të licencës; ose

ii. një deklaratë të pavërtetuar të ndryshimit të licencës, përmbajtja e së cilës korrespondon me formularin e deklaratës së ndryshimit të licencës së parashikuar në këto rregullore dhe të nënshkruar si nga mbajtësi ashtu edhe nga i licencuari.

b) Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë, që çdo bashkëmbajtës i cili nuk është palë në kontratën e licencës, të japë pëlqimin e tij, lidhur me ndryshimin e saj dokument të nënshkruar prej saj.

4. (Dokumentet mbështetëse për anulimin e regjistrimit të një licence) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për anulimin e regjistrimit të një licence të shoqërohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, nga një prej elementeve nga sa vijon:

i. dokumente që vërtetojnë anulimin e kërkuar të regjistrimit të licencës; ose

ii. një deklaratë të pavërtetuar të anulimit të licencës, përmbajtja e së cilës përputhet me formularin e deklaratës së anulimit të licencës së parashikuar në këto rregullore dhe të nënshkruar si nga mbajtësi sikundër edhe nga i licencuari.

SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF TRADEMARKS
RESOLUTION BY THE DIPLOMATIC CONFERENCE SUPPLEMENTARY TO THE
SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF TRADEMARKS

(done at Singapore on March 27, 2006)

AND

REGULATIONS UNDER THE SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF
TRADEMARKS

(as in force on November 1, 2011)
CONTENTS

Page

Singapore Treaty on the Law of Trademarks

Resolution by the Diplomatic Conference Supplementary to the
Singapore Treaty on the Law of Trademarks

Regulations Under the Singapore Treaty on the Law of Trademarks

SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF TRADEMARKS

SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF TRADEMARKS

List of Articles

- Article 1: Abbreviated Expressions
- Article 2: Marks to Which the Treaty Applies
- Article 3: Application
- Article 4: Representation; Address for Service
- Article 5: Filing Date
- Article 6: Single Registration for Goods and/or Services in Several Classes
- Article 7: Division of Application and Registration
- Article 8: Communications
- Article 9: Classification of Goods and/or Services
- Article 10: Changes in Names or Addresses
- Article 11: Change in Ownership
- Article 12: Correction of a Mistake
- Article 13: Duration and Renewal of Registration
- Article 14: Relief Measures in Case of Failure to Comply with Time Limits
- Article 15: Obligation to Comply with the Paris Convention
- Article 16: Service Marks
- Article 17: Request for Recordal of a License

Article 18: Request for Amendment or Cancellation of the Recordal of a License
Article 19: Effects of the Non-Recordal of a License
Article 20: Indication of the License
Article 21: Observations in Case of Intended Refusal
Article 22 Regulations
Article 23: Assembly
Article 24: International Bureau
Article 25: Revision or Amendment
Article 26: Becoming Party to the Treaty
Article 27: Application of the TLT 1994 and This Treaty
Article 28: Entry into Force; Effective Date of Ratifications and Accessions
Article 29: Reservations
Article 30: Denunciation of the Treaty
Article 31: Languages of the Treaty; Signature
Article 32: Depositary

Article 1
Abbreviated Expressions

For the purposes of this Treaty, unless expressly stated otherwise:

- (i) “Office” means the agency entrusted by a Contracting Party with the registration of marks;
- (ii) “registration” means the registration of a mark by an Office;
- (iii) “application” means an application for registration;
- (iv) “communication” means any application, or any request, declaration, correspondence or other information relating to an application or a registration, which is filed with the Office;
- (v) references to a “person” shall be construed as references to both a natural person and a legal entity;
- (vi) “holder” means the person whom the register of marks shows as the holder of the registration;
- (vii) “register of marks” means the collection of data maintained by an Office, which includes the contents of all registrations and all data recorded in respect of all registrations, irrespective of the medium in which such data are stored;
